

**Qëndrimi i Komisionerit në lidhje me mënyrën e përlogaritjes së kuotës
20% dhe 15% për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët, të
mesme dhe të lartë drejtuese, në rastet kur procedura është e hapur edhe
për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil në institucionet e pavarura
dhe njësitë e vetqeverisjes vendore**

Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë në shërbimin civil, rregullohet në nenet 25-26, të kreut V, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

Në pikën 1, të nenit 26, të këtij ligji, përcaktohet se:

“Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.”

Më tej, sipas pikës 2, të nenit 26, këto procedura organizohen nga njësia përgjegjëse, për një ose disa pozicione të lira të ngjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20, të ligjit nr.152/2013.

Ndërsa në pikën 4, të këtij neni, ligjvënësi ka parashikuar një rast përjashtimor, sipas së cilit:

“Përjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.”

Në zbatim të pikës 9, të nenit 26, të ligjit në fjalë, Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, ka miratuar kushtet dhe procedurën e hollësishme për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese.

Konkretisht, në pikën 43, të kreut III “Ngritja në detyrë”, të këtij vendimi përcaktohet se:

“Në rast se një vend vakant në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe Këshilli i Ministrave për institucionet e administratës shtetërore apo organi kompetent për institucionet e pavarura, ka marrë vendim në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, atëherë në procedurën e ngritjes në detyrë kanë të drejtë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.”

Duke qenë se, në dispozitat e cituara më lart, nuk ka një parashikim shterues për mënyrën e përlogaritjes së kuotës 20%, në rastin e plotësimit të pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët apo të nivelit të mesëm drejtues, me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, (kur ndodhemi përpara faktit se, këto pozicione nuk janë plotësuar

*nëpërmjet procedurave të konkurrimit me lëvizje paralele apo ngritje në detyrë), **për institucionet e pavarura edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore** Komisioneri ka mbajtur qëndrimin se, kuota prej 20% për plotësimin e këtyre pozicioneve me kandidatë nga jashtë shërbimit civil duhet të përlloragitet mbi numrin e përgjithshëm të pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të nivelit të mesëm drejtues, të parashikuar në organikën e institucionit për vitin kalendarik.*

Në këtë përfundim është arritur, për të mundësuar zbatimin e kësaj dispozite, edhe në këto tipologji të institucioneve, në kushtet kur kanë një numër të kufizuar të pozicioneve të punës, ndryshe nga institucionet e nivelit qendror, ku përlloragitja bëhet mbi numrin e përgjithshëm të pozicioneve të lira të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues në të gjithë administratën shtetërore.

Ndërsa, sa i përket mënyrës së përlloragitjes së kuotës 15%, për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, sqarojmë se, rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, (*lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*), në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të parashikuara në nenin 32, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”.

Komisioneri sjell në vëmendje të njësisë përgjegjëse të institucionit se, në kushtet kur institucioni ndodhet përpara pamundësisë së plotësimin të pozicioneve të kategorisë së nivelit të lartë drejtues me konkurrim të hapur, legjislacioni i shërbimit civil i njeh të drejtën, për ti plotësuar këto pozicione me pranim nga jashtë shërbimit civil, në respektim të pikës 1, të nenit 32, “*Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Ky rregull ligjor i jep tagrin titullarit/organit vendimmarrës të institucionit të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, me kushtin që ky numër të mos jetë më shumë se 15 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për institucionin. Në rastin e institucioneve të pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, për shkak të numrit të ulët të pozicioneve të kësaj kategorie, me qëllim që të mundësohet aplikimi i kësaj dispozite, për të gjitha rastet, nis me 1 pozicion pune pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicione të kategorisë së nivelit të lartë drejtues.

Sjellim në vëmendjen të institucioneve, se organet e ngarkuara për ndjekjen e procedurës së rekrutimeve, duhet të kenë edhe mbështetjen e njësisë juridike në institucion, me qëllim orientimin e saktë për zbatimin e ligjit, në raste të nevojës për interpretim të aspekteve të ndryshme që rregullojnë administrimin e shërbimit civil.